

Nr: 10-86  
Shkup: 30.09.2020

Në bazë të nenit 10 dhe nenit 15 paragrafi (3) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke vepruar sipas Njoftimit për ndarje të planifikuar të ndihmës nr. 10-86 të datës 24.09.2020, i parashtruar nga Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik, si dhënës i ndihmës shtetërore, bazuar në Rregulloren për ndarje të mjeteve financiare përmes vauçerëve të inovacionit, në seancën e mbajtur më 30.09.2020, solli

### AKTVENDIM

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës gjatë shqyrtimit të Njoftimit për ndarje të planifikuar të ndihmës nr. 02-756/10 të datës 23.09.2020(Numri ynë 10-86 të datës 24.09.2020), i parashtruar nga Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik, si dhënës i ndihmës shtetërore, bazuar në Rregulloren për ndarje të mjeteve financiare përmes vauçerëve të inovacionit, konstatoi **se ndarja e mjeteve financiare nëpërmjet vauçerëve të inovacionit paraqet ndihmë me vlerë të vogël (de minimis)** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 4) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore dhe nenit 4 të Rregullores për kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës me vlerë të vogël (de minimis) dhe e njëjta **nuk është ndihmë shtetërore** në përputhje me nenin 9 paragrafi (1) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore, me ç’rast ndarja e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis) duhet të bëhet në përputhje me Rregulloren për kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës me vlerë të vogël (de minimis) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 141/2011).

### Arsyetim

Në përputhje të nenit 10 të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: KMK) është kompetent për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e çdo forme të mbështetjes, përkatësisht nëse e njëjta paraqet apo jo ndihmë shtetërore në kuptim të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore.

Çdo dhënës i ndihmës shtetërore (i përcaktuar në nenin 6 paragrafi (1) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore) është i detyruar, sipas nenit 13 paragrafi (1) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore, në KMK, të dorëzojë njoftim për çdo plan për ndarjen e ndihmës së re shtetërore ose ndryshimin e ndihmës shtetërore ekzistuese, pa dallim nëse e njëjta ndahet si ndihmë individuale apo skemë e ndihmës.

Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik, duke vepruar në përputhje me detyrimin nga neni 13 i Ligjit për Kontroll të ndihmës shtetërore, në Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dorëzoi njoftim për ndarje të planifikuar të ndihmës nr. 10-86 të datës 24.09.2020, në lidhje me Rregulloren për ndarje të mjeteve financiare nëpërmjet vauçerëve të inovacionit.

Duke pasur parasysh se njoftimi i dorëzuar i përmban të dhënat e nevojshme për vlerësimin e ndihmës në pajtim me nenin 14 paragrafi (1) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10. ) si ditë e pranimit të njoftimit të rregullt konsiderohet 24.09.2020.

KZK në afatin e paraparë me ligj, e shqyrtoi njoftimin e dorëzuar dhe konstatoi se ndarja e mjeteve financiare përmes Rregullores për ndarjen e mjeteve financiare përmes vauçerëve të inovacionit

paraqet **ndarje të ndihmës me vlerë të vogël (de minimis)**. Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik, me Rregulloren për ndarje të mjeteve financiare përmes vauçerëve të inovacionit, ndan vauçerë të inovacionit, qëllimi i të cilit është nxitja e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve dhe institucioneve akademike dhe kërkimore-shkencore në drejtim të zbatimit të aktiviteteve inovative, me të cilat ndërmarrjet do të rrisin konkurrencën e tyre.

Në përputhje me këtë Rregullore, vauçerët e inovacionit mund të përdoren për të mbuluar deri në 80% (tetëdhjetë për qind) nga shpenzimet e përgjithshme të shërbimeve shkencore dhe kërkimore, në shumën maksimale prej 500.000 (pesëqind mijë) denarë (MKD), pa tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe është në përputhje me nenin 4 të Rregullores për kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës me vlerë të vogël (de minimis). Gjithashtu, në Rregullore thuhet se shuma e mjeteve të ndara përmes vauçerëve të inovacionit nuk duhet të jetë në kundërshtim ose të shkelë rregullat për ndarje të ndihmës shtetërore me vlerë të vogël (de minimis) - të përcaktuara në Rregulloren për kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës me vlerë të vogël ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 141/11).

Në Rregulloren për ndarje të mjeteve financiare përmes vauçerëve të inovacionit, janë përcaktuar qartë kriteret e përshtatshmërisë që duhet t'i plotësojë aplikanti, ndër të cilat kriteret janë edhe kushtet për ndarje të ndihmës de minimis në përputhje me Rregulloren për kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës me vlerë të vogël (de minimis).

Konkretisht, sipas nenit 9 të Ligjit për Kontroll të ndihmës shtetërore, ndihma me vlerë të vogël (de minimis) nuk është ndihmë shtetërore. Kushtet dhe procedura për ndarje të ndihmës me vlerë të vogël përcaktohen në Rregulloren për kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës me vlerë të vogël (de minimis). Në këtë drejtim, ndihma me vlerë të vogël mund të ndahet vetëm nëse e njëjta në mënyrë kumulative i plotëson kushtet e nenit 3 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarje të ndihmës me vlerë të vogël (de minimis). Gjithashtu, në lidhje me regjistrimin e ndihmës, në përputhje me nenin 8 paragrafi (1) të Rregullores për kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës de minimis, Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik duhet të mbajë shënime të sakta në lidhje me çdo ndihmë të ndarë dhe veçanërisht për shumën, marrësin, kohën, qëllimin dhe mënyrën e ndarjes së ndihmës dhe të njëjtën duhet ta ruajnë për 10 vjet nga dita kur e kanë ndarë herën fundit. Për këtë qëllim dhe në përputhje me nenin 8 paragrafi (3) të Rregullores për kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës me vlerë të vogël (de minimis), Fondi duhet t'i paraqesë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të dhënat për çdo ndihmë të ndarë në një formular të plotësuar të dhënë në Shtojcë, që është pjesë përbërëse e Rregullores për kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës me vlerë të vogël (de minimis). Përkatësisht, Fondi duhet të fillojë me plotësimin e këtij formulari pasi të dihen përfituesit e ndihmës dhe i njëjti sipas nenit 8 paragrafi (4) të dorëzohet në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës para ndarjes së ndihmës, e nëse kjo nuk është e mundur, menjëherë sapo të jetë e mundur.

Në bazë të asaj që u tha më lartë, KMK vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Udhëzim juridik** : Kundër këtij vendimi mund të parashtrahet padi për ngritjen e kontestit administrativ në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Kontroll të ndihmës shtetërore. Padia nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit, përveç në rast kur Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës do të urdhërojë kthimin e ndihmës shtetërore të paligjshme ose të keqpërdorur, ndarja e secilës nuk lejohet.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**

